

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI PËR ANKESA TË KPA-së
VEÇE ZA ŽALBE KPA-a**

GSK-AKP-A-9/11

Prishtinë, 10 Qershor 2011

Në çështjen civile të

N.A.

Ankuesi/Paraqitësi i kërkeses

Kolegji për Ankesa të AKP-ës, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e kolegjit, Anne Kerber dhe Sylejman Nuredinin, Gjyqtarë, duke vendosur me ankesen kundër vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/61/2010, KPCC/D/A/70/2010, dhe KPCC/D/A/77/2010, (shkresat e lëndës të regjistruara me numrat AKP 38328, AKP 38329, AKP 38330, AKP 38331, AKP 38332, AKP 38333, AKP 38322, AKP 38323, AKP 38324, AKP 38325, AKP 38326, AKP 38305, AKP 38306, AKP 38308, AKP 38309, AKP 38311, AKP 38317, AKP 38318, AKP 38319, AKP 38320, AKP 38321, AKP 38313, AKP 38314, AKP 38315, AKP 38316, dhe AKP 38312), të datave 25 shkurt, 21 prill dhe 16 qershor 2010, pas seancës së mbajtur më 10 June 2011, lëshon këtë

AKTGJYKIM

- 1- Ankesat e paraqitura nga N.F. më 24 shkurt 2011 dhe të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-9/11 deri 34/11 janë bashkuar në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-9/34.**

- 2- Ankesat e parashtruara nga N.F. më 24 shkurt 2011 janë refuzuar si të pa bazuara.
- 3- Ankesa e parashtruar nga N.F. me datë 24 shkurt 2011 në emër të K., V., L., Z. dhe S.S. janë hedhë si të palejueshme.
- 4- Vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/61/2010, KPCC/D/A/70/2010, dhe KPCC/D/A/77/2010, në pjesët që kanë të bëjnë me lëndët të regjistruara me numrat Nr. AKP 38328, AKP 38329, AKP 38330, AKP 38331, AKP 38332, AKP 38333, AKP 38322, AKP 38323, AKP 38324, AKP 38325, AKP 38326, AKP 38305, AKP 38306, AKP 38308, AKP 38309, AKP 38311, AKP 38317, AKP 38318, AKP 38319, AKP 38320, AKP 38321, AKP 38313, AKP 38314, AKP 38315, AKP 38316, dhe AKP 38312, vërtetohen.
- 5- Shpenzimet e procedurës të përcaktuara në shumë prej 240 Euro (dyqindë e katërdjetë euro) do të mbuloohen nga ankuesi, N.F. dhe do t'i paguhen Gjykatës Supreme mbrenda afatit prej 90 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Historia faktike dhe procedurale:

Më 29 nëntor 2007, N.F., duke vepruar si kryefamiljar në emër të nënës së tij ka paraqitur 26 (njëzetegjashtë) kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) me të cilat kërkonte që të njihet si pronar i parcelave të ndryshme të tokës ose pyllit të fituara përmes trashëgimisë dhe që ato t'i kthehen në posedim. Ai ka sqaruar se këto parcela i kanë takuar nënës së tij Z.S. dhe se ato ishin uzurpuar në mënyrë të kundërligjshme nga një person i panjohur. Ai ka pohuar se kishte humbur posedimin më 19 qershor 1999 si rezultat i konfliktit të armatosur.

Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai i ka siguruar AKP-së dokumentacionin në lidhje me statusin e tij civil dhe të prindërve të tij, si në vijim:

- 1- Certifikatën e tij të lindjes,
- 2- Kopjen e letërnjoftimit të tij,
- 3- Certifikatën e vdekjes së nënës së tij, Z.S, mbiemri i vajzërisë S.,
- 4- Deklaratën e nënshkruar nga dy dëshmitarë të cilët vërtetojnë se Z.S., Z.S. dhe Z.F. janë emra të ndryshëm të një personi të vetëm,

- 5- Certifikatën e vdekjes së F.S.,
- 6- Certifikatën e martesës së S.P. dhe Z.S.,
- 7- Certifikatën e martesës së S.S..

Dokumentacioni të cilin ai e ka dorëzuar në AKP lidhur me parcelat të cilat ai kinse i kishte trashëguar nga nëna e tij, është si në vijim:

Nr. i lëndës së AKP-së	Data parcelës së kërkuar	Dokumentacioni i paraqitur
Lënda AKP 38328	Parcela Nr. 3290 prej 0, 69, 62 ha me lokacion në “Vruce Padine”, zona kadastrale (ZK) Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 265, Gjilan, dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/3 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38329	Parcela Nr. 1299 prej 0, 10, 17 ha me lokacion në “Bara”, ZK Zebincë , Komuna e Novobërdës	Fleta poseduese Nr. 113, Novobërdë, e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38330	Parcela Nr. 1851 prej 0, 36, 07 ha me lokacion në “Lepi Dub”, ZK Zebincë, Komuna e Novobërdës	Fleta poseduese Nr. 113, Novobërdë, e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda e AKP-së 38331	Parcela Nr. 1866 prej 0, 13, 20 ha me lokacion në “Popov Zabel”, ZK Zebincë, Komuna e Novobërdës	Fleta poseduese Nr. 113, Novobërdë, e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38332	Parcela Nr. 1868 prej 0, 14, 81 ha me lokacion në “Lepi Dub”, ZK Zebincë, Komuna e Novobërdës	Fleta poseduese Nr. 113, Novobërdë, e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38333	Parcela Nr. 1869 prej 0, 04, 50 ha me lokacion në “Lepi Dub”, ZK Zebincë, Komuna e Novobërdës	Fleta poseduese Nr. 113, Novobërdë, e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38322	Parcela Nr. 3257 prej 0, 06, 75	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan

	ha me lokacion në “Lekovita Voda”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38323	Parcela Nr. 3258 prej 0, 04, 15 ha me lokacion në “Lekovita Voda”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38324	Parcela Nr. 3271 prej 0, 74, 02 ha me lokacion në “Potajiste”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38325	Parcela Nr. 3272 prej 0, 84, 62 ha me lokacion në “Potajiste”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38326	Parcela Nr. 3288 prej 0, 36, 21 ha me lokacion në “Potajiste”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38305	Parcela Nr. 978 prej 0, 35, 88 ha me lokacion në “Ciganska Padina”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38306	Parcela Nr. 979 of 0, 05, 76 ha me lokacion në “Ciganska Padina”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.

Lënda AKP 38308	Parcela Nr. 981 of 0, 81, 79 ha me lokacion në “Ciganska Padina”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38309	Parcela Nr. 988 prej 0, 10, 57 ha me lokacion në “Pod Vrmaniti”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38311	Parcela Nr. 993 prej 0, 24, 86 ha me lokacion në “Pod Vrmaniti”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38317	Parcela Nr. 3222 prej 1, 22, 47 ha me lokacion në “Golemi Zabe”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38318	Parcela Nr. 3226 prej 0, 19, 76 ha me lokacion në “Silajsti Kamen”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38319	Parcela Nr. 3254 prej 0, 11, 10 ha me lokacion në “Lekovita Voda”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38320	Parcela Nr. 3255 prej 0, 68, 42 ha me lokacion në “Lekovita Voda”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i

		takon Z.S.
Lënda AKP 38321	Parcela Nr. 3256 prej 0, 20, 21 ha me lokacion në “Lekovida voda”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38313	Parcela Nr. 995 prej 0, 97, 02 ha me lokacion në “Pod Vrmaniti”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38314	Parcela Nr. 1020 prej 0, 09, 27 ha me lokacion në “Potok”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38315	Parcela Nr. 1021 prej 2, 01, 14 ha me lokacion në “Potok”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38316	Parcela Nr. 3220 prej 0, 50, 43 ha me lokacion në “Golo Zebe”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.
Lënda AKP 38312	Parcela Nr. 994 prej 0, 24, 86 ha me lokacion në “Pod Vrmaniti”, ZK Parallovë, Komuna e Gjilanit	Fleta poseduese Nr. 260, Gjilan dhe certifikata e të drejtave pronësore të patundshmërisë e cila shkruan se 1/1 e parcelës i takon Z.S.

Në pajtim me procedurat, zyrtarët e AKP-së kanë shkruar në lokacionin ku gjenden parcelat dhe kanë vendosur shenja të cilat tregojnë se prona është objekt i kërkesës dhe se palët e interesuara duhet t'i

paraqesin përgjigjet e tyre brenda një muaji. Në raportet e tyre të njoftimit, AKP-ja ka vërejtur se njoftimi është bërë në mënyrë të duhur në bazë të “koordinatave ortofoto dhe GPS-it” dhe me ndihmën e fqinjëve, parcelat e kontesueshme nuk ishin uzurpuar (AKP 38328: pyll i dëmtuar, AKP 38329: livadh, AKP 38323: pyll) ose jo në shfrytëzim dhe i uzurpuar nga një person i panjohur (AKP 38330, AKP 38331 dhe AKP 38332: pyll, AKP 38333: livadh, AKP 38324: pyll, AKP 38325: tokë e punueshme, AKP 38326 dhe AKP 38305: pyll, AKP 38306: livadh, AKP 38308: tokë e punueshme, AKP 38309, AKP 38311, AKP 38317, AKP 38318 dhe AKP 38319: pyll, AKP 38320: tokë e punueshme, AKP 38321: livadh, AKP 38322 dhe AKP 38313: tokë e punueshme, AKP 38314: livadh, AKP 38315 dhe AKP 38316: pyll, AKP 38312: livadh).

Pasi që asnjë i paditur nuk kishte paraqitur përgjigje brenda afatit, të gjitha kërkesat janë konsideruar si jokontestuese.

Raportet verifikuese të AKP tregojnë se dokumentacioni i lartpërmendur lidhur me statusin civil të paraqitësit të kërkesës dhe të anëtarëve të familjes së tij si dhe lidhur me parcelat ishin të bazuara dhe janë vërtetuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Komunës së Novobërdës dhe nga Zyra Kadastrale e Gjilanit dhe Novobërdës.

Me anë të tri vendimeve të ndryshme përkatësisht me 25 shkurt, 21 prill dhe 16 qershor 2010, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK ose Komisioni) ka hedhur poshtë të gjitha kërkesat për shkak të mungesës së dëshmimeve të kapacitetit të paraqitësit të kërkesës për të paraqitur kërkesë në emër të bartëses së të drejtave pronësore. KKPK-ja nuk ka qenë e bindur se paraqitësi i kërkesës ka qenë anëtar i familjes i të ndjerës bartëses së të drejtave të pronës për shkak të dallimeve në emrat të cilët paraqiteshin në certifikatat e statusit civil të cilat e kanë pamundësuar që të vërtetohet lidhja në mes të paraqitësit të kërkesës dhe bartëses së të drejtave pronësore.

Paraqitësi i kërkesës ka pranuar vendimet e KKPK-së më 28 janar 2011.

Më 24 shkurt 2011, N.F. (tani e tutje ankuesi) ka paraqitur 26 (njëzetegjashtë) ankesa pranë Gjykatës Supreme kundër vendimeve të lartpërmendura.

Në ankesat e tij, ai pohon se vendimet e shkallës së parë janë marrë mbi vërtetimin e gabuar ose jo të plotë të fakteve; ai pretendon se dy data të ndryshme të lindjes të cilat paraqiten në dy dokumente në lidhje me identitetin e nënës së tij kanë qenë për shkak të përdorimit të dy kalendarëve të ndryshëm në Serbi. Për më tepër, ai sqaron se babai i tij është lindur me emrin S.P., babai i tij pastaj është

adoptuar nga F.S. mbiemrin e të cilit e ka marrë, dhe se babai i tij ia kishte dhënë atij atë mbiemër si shenjë mirënjohjeje ndaj babait birësues, emrin N.F.. Ai shton se prindërit e tij ishin S.S. dhe Z.S. (mbiemri i vajzërisë S.) dhe se kanë pasur gjashtë fëmijë, atë dhe pesë vajza mbiemri i të cilave është S..

Në rast se Gjykata nuk bindet me sqarimin e tij, ai ka kërkuar që t'i njihet e drejta pronësore mbi parcelat cilësdo nga motrat e tij, mbiemri i të cilave nuk është në kundërshtim me mbiemrin e nënës së tyre, duke deklaruar se motrat e tij jetojnë dhe punojnë jashtë vendit.

Në mbështetje të ankesave të tij, ai i ka siguruar Gjykatës Supreme dokumentacion shtesë: certifikatën e lindjes të njëres nga motrat e tij (Z.S. mbiemri i burrit N.) dhe dy deklarata të dëshmitarëve të cilat vërtetojnë vërtetësinë e deklaratës së tij.

Arsyetimi ligjor:

Bashkimi i ankesave:

Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale përcakton se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkëputura kur për bashkimin apo shkrirjen e tillë është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen i mundëson Komisionit që t'i bashkojë apo shkëputë kërkesat për qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave për tu marrë parasysh.

Sa i përket dispozitave të Ligjit mbi Procedurën Civile të cilat janë të zbatueshme në procedurën ankimore pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, nenin 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parashihet që ankesat mund të bashkohen në një padi nëse një bashkim i tillë i kontribuon efikasitetit të procedurës.

Në lëndët në fjalë, ankuesi ka parashtruar vetëm një ankesë, ku në mënyrë joshprehimore ka dhënë pëlqimin e tij për bashkimin e lëndëve, ashtu siq është paraparë me nenin 408.3 të LPK-ës. Më tutje Gjykata Supreme e Kosovës vëren se faktet, baza ligjore dhe çështja e provave janë plotësisht të njëjta në të 26 (njëzetegjashtë) lëndët. Vetëm parcelat, objekti i të drejtës pronësore i cili pretendohet

në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Në të vërtetë, deklarata e ankuesit si dhe parashtrirat që ai i ka siguruar me ankesat e tij janë kopjuar dhe janë paraqitur në secilën lëndë të AKP-së e cila korrespondon me dosjen e parcelës së kërkuar. Përveç kësaj, arsyetimi ligjor i vendimeve të KKPK-së, pjesa që ka të bëjë me kërkesat e N.F. janë plotësisht të njëjta.

Deri në këtë moment, pasi që të gjitha elementet e lëndës janë të njëjta përveç parcelave, është e qartë se do të jetë më efikase nëse bashkohen ankesat dhe ato të ekzaminohen në një aktgjykim të vetëm.

Rastet e regjistruara me numërat GSK-KPA-A-9/11 deri 34/11 janë e njëjta lëndë dhe me numër GSK-KPA-A-9/11

Pranueshmëria e ankesave:

Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIKU-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin,

Në lëndët në fjalë, të gjitha ankesat janë paraqitur nga pala e cila i cili ka qenë paraqitës i kërkesës në procedurën e shkallës së parë më 24 shkurt 2011, e që është më pak se 30 ditë pas pranimit të njoftimit mbi vendimet e KKPK-së.

Prandaj, ankesat janë të pranueshme.

Meritat:

1- Çështjet e statusit civil:

Në lidhje me ankesën e regjistruar me numër GSK-KPA-A-30/11, Gjykata Supreme vëren se ajo është shprehimisht është ushtruar kundër vendimit të KKPK-ës që ka të bëjë me kërkesën e paraqitur në AKP me numër KPA 38313. Nga origjinali i lëndës së AKP-ës, shihet qartë se kërkesa e parashtruar në këtë rast është shqyrtësuar në tërësinë e saj nga Sekretariati Ekzekutiv dhe i është referuar KKPK-ës me datë 28 Janar 2010. Më pastaj, vendimi grupor i KKPK-ës KPCC/D/A/61/2010 i është dorëzuar ankuesit së bashku me ekzemplarën e veçant të vendimit. Sidoqë të jetë, edhe pse numri “KPA 38313” është cekur në ekzemplarën e veçant të vendimit

(gjithashtu të ashtquajatur si vendim individual), vendimi grupor nuk i referohet këtij numri. Me letren e 15 Prillit 2011 gjyqtari përgjegjës ka pyetur AKP-ën nëse rasti KPA 38313 me të vërtetë është vendosur nga KKPK-ja ose jo. Në përgjigjen e tyre të datës 27 Prill 2011, AKP-ja ka konfirmuar se ky rast është shqyrtuar dhe vendosur nga ana e KKPK-ës. Kjo shihet edhe nga procesverbali dhe fletagjithpërfshirëse e seancës shqyrtuese. Shihet fare qartë se është bërë gabim vetëm në të shtypur që ky rast nuk është përmendur të vendimin grupor të KKPK-ës edhe pse komisioni ka vendosur për këtë. Si pasojë e kësaj, Gjykata Supreme është e bindur që lënda KPA 38313 është vendosur në shkallën e parë dhe do të vlerësojë ankesën e parashtruar kundër vendimit të komisionit që ka të bëjë me atë.

Çështjet meritore

1-Çështjet e satusit civil:

Si çështje paraprijëse, Gjykata Supreme e Kosovës vëren se në bazë të dokumentacionit të siguruar nga paraqitësi i kërkesës dhe raporteve të verifikimit të Sekretariatit Ekzekutiv, Komisioni ka vlerësuar në mënyrë të duhur se parcelat, objekt i kërkesës, i kanë takuar Z.S. e cila ka vdekur më 4 korrik 1994. Këto fakte nuk kontestohen apo kundërshtohen as nga paraqitësi i kërkesës e as nga Komisioni.

Sidoqoftë, Komisioni konsideron se dokumentacioni i cili është sjellë në mënyrë që të dëshmohet lidhja në mes të Z.S. dhe paraqitësit të kërkesës nuk janë të kënaqshme pasi që përmbajnë disa mospërputhje.

Siç ka konstatuar Komisioni, edhe Gjykata Supreme vëren se certifikatat e vdekjes dhe të martesës së Z.S. paraqesin data të ndryshme të lindjes: 27 nëntor 1922 në certifikatën e vdekjes, kurse 14 nëntor 1922 në certifikatën e martesës. Në ato dy certifikata, mbiemri i vajzërisë së Z.S., “S.” dhe vendi i lindjes, “Manishincë”, Prishtinë” janë identike. Ankuesi sqaron se ky ndryshim është për shkak se janë përdorur dy kalendarë të ndryshëm.

Një hulumtim i shpejtë në lidhje me kalendarët tregon se pas përdorimit të kalendarit Julian, në vitin 1918 Serbia ka miratuar kalendarin Gregorian dhe se tabela e konvertimit në mes të dy kalendarëve jep një dallim prej +13 (trembëdhjetë) ditëve, që nga viti 1900. Gjykata Supreme vëren se dy datat e lindjes të cilat paraqiten në certifikatat e Z.S., mbiemri i vajzërisë S. kanë dallim prej 13 (trembëdhjetë) ditëve dhe se viti i saj i lindjes (1922) nuk është shumë larg pas miratimit të kalendarit

të ri në Serbi. Një përputhje e tillë e bën Gjykatën Supreme të mendoj se sqarimi i dhënë nga ankuesi lidhur me këtë mospërputhje duhet seriozisht të merret në konsideratë.

Më të vështira janë dallimet e emrave të cilat i krijojnë vështirësi Komisionit që të vërtetojë lidhjen familjare në mes të paraqitësit të kërkesës dhe bartëses së të drejtës së pronësisë.

Komisioni i shkallës së parë ka ngritur në mënyrë të duhur çështjen e lidhjes familjare.

Identiteti i bartëses së të drejtës së pronësisë përmendet si Z.S. në fletën poseduese dhe në certifikatën e patundshmërisë të cilat i janë siguruar Komisionit. Ku ata janë në lidhje me bartësen e të drejtave pronësore, dokumentet e statusit civil të ofruara nga paraqitësi i kërkesës mbajnë emrat në vijim: Z.S. në certifikatën e saj të martesës, Z.S. mbiemri i vajzërisë S. në certifikatën e saj të vdekjes, Z.S. në certifikatën e vdekjes së burrit të saj. Certifikata e martesës tregon se dhëndri quhet S.P. përderisa i njëjti e ka emrin S.S. në certifikatën e tij të vdekjes (data e lindjes e njëjtë dhe emrat e njëjtë të prindërve) dhe në certifikatën e vdekjes së gruas së tij. Sidoqoftë, asnjëri prej këtyre dokumenteve nuk përputhet me dokumentet e statusit civil të ankuesit: certifikata e lindjes së ankuesit dhe kartela e identifikimit përmendin emrin e tij N.F.. Në certifikatën e tij të lindjes, prindërit e tij janë S.F. dhe Z.F. të lindur në Zebnicë dhe Minishnicë, respektivisht. Fatkeqësisht, datat e lindjes së prindërve të tij dhe numrat e identifikimit nuk janë të paraqitura. Edhe pse mundësia për t'i gjetur disa çifte emrat e të cilëve janë S. i lindur në Zebnicë dhe Z. e lindur në Manishnicë mund të jetë e dobët, mbetet mundësia që prindër të tjerë me këta emra dhe të lindur në këto vende të kenë ekzistuar. Prandaj, indikacionet e tilla nuk mund të përbëjnë dëshmi të fuqishme dhe të mjaftueshme të lidhjes familjare në mes të ankuesit dhe bartëses së të drejtës pronësore.

Për më tepër, ankuesi pohon se mbiemri F. i është dhënë në shenjë mirënjohjeje ndaj gjyshit të tij i cili e kishte adoptuar babin e tij. Në të vërtetë, certifikata e vdekjes e gjyshit të pretenduar F.S., e mban emrin F.. Megjithatë, edhe pse kjo përbën një sqarim të mundshëm të mospërputhjeve, nuk i eliminon mundësitë tjera dhe për këtë arsye nuk dëshmon me siguri të plotë pse nuk përmendet mbiemri S. përveç emrit F. alias, pse nuk përmenden data e lindjes dhe/ose numrat personal të prindërve të ankuesit në certifikatat e tij të lindjes.

Dokumentet plotësuese të cilat i ka sjellë ankuesi me ankesën e tij, certifikata e lindjes e njëres nga motrat e tij të pretenduara, nuk e mundëson vërtetimin e lidhjes së kontestueshme në mes të ankuesit dhe bartëses së të drejtave pronësore. Ajo ka të bëjë me Z.N., mbiemri i vajzërisë S., nga S.S. dhe Z.S., S.. Gjykata Supreme vëren se përkundër asaj që është bërë në certifikatën e lindjes së ankuesit,

datat e lindjes së prindërve janë të paraqitura në certifikatën e tij të lindjes. Një indikacion i tillë i cili kontribuon në sqarimin e plotë të identifikimit të prindërve çuditërisht mungon në certifikatën e lindjes së ankuesit, kurse është paraqitur në atë tjetrën.

Ankuesi gjithashtu i ka siguruar Gjykatës Supreme dy deklarata e reja të dëshmitarëve të cilët e kanë paraqitur vetën si shërbyes të prindërve të tij, duke e vërtetuar vërtetësinë e sqarimeve të tij. Ai më parë i kishte siguruar Sekretariatit Ekzekutiv një deklaratë të nënshkruar nga dy dëshmitarë të cilët vërtetonin se Z.S. mbiemri i vajzërisë Simijonovic dhe Z.F. janë emrat e një personi të njëjtë. Gjykata Supreme duhet të ekzaminojë nëse deklaratat e shkruara nga dëshmitarët mund të përbëjnë dëshmi adekuate për lidhjen familjare në këtë lëndë. Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 i kufizon kompetencat e KKPK dhe të Gjykatës Supreme të cilët merren me ankesat kundër vendimeve të KKPK-së për zgjidhjen e konflikteve që kanë të bëjnë me kërkesa të pronësisë. Çështja e lidhjes familjare e paraqitësit të kërkesës/ankuesit ngrit çështjen e vërtetimit të amësisë ose të korigjimit të akteve të statusit civil ose të trashëgimisë, të gjitha çështjet ligjore të cilat bien nën kompetencat e gjykatave tjera apo organeve administrative dorëzohen në procedurë specifike. Vetëm përmes procedurave të tilla një gjykatë kompetente ose organ administrativ mund të vlerësojë fuqinë dhe vlefshmërinë e dëshmive për ta vërtetuar lidhjen e amësisë dhe/ose të korigjojë mospërputhjet në statusin civil të ankuesit. Gjykata Supreme në cilësinë e Gjykatës së Apelit kundër vendimeve të Komisionit duhet të kontrollojë nëse pala ka kapacitetin e nevojshëm për të vepruar pranë saj, mirëpo duhet të jetë përtej fushëveprimit të kompetencave të saj për ta zgjidhur çështjen që ka të bëjë me vërtetimin e lidhjes familjare.

Sekretariati Ekzekutiv është munduar ta sqarojë lidhjen familjare në mes të ankuesit dhe Z.S., duke kërkuar disa dokumentacion plotësues dhe duke kërkuar nëse librat e regjistrimit civil përmbajnë më shumë informata, në mes tjerash numrat personal. Këto përpjekje kanë dështuar.

Duke i marrë parasysh të gjithë këta faktorë, Gjykata Supreme konsideron se Komisioni ka vendosur në mënyrë të ligjshme se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për lidhjen familjare në mes të paraqitësit të kërkesës dhe bartëses së të drejtave pronësore dhe, si rezultat, paraqitësi i kërkesës nuk ka pasur të drejtë të veprojë si kryefamiljar i familjes së Z.S..

2- Kërkesa e paraqitur nga ankuesi në emër të motrave të tij, K., V., L., Z. dhe S.S.:

Ankuesi ka formuluar një kërkesë të re në ankesën e tij duke kërkuar nga Gjykata Supreme që në rast se nuk bindet se ai është djali i Z.S., t'ia njoh të drejtat pronësore mbi parcelat cilëso nga motrat e tij,

duke deklaruar se ato nuk i kanë mospërputhjet e njëjta në dokumentacionin e statusit civil. Ai shton se motrat e tij jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, duke vepruar në emër të tyre si kryefamiljar i familjes.

Gjykata Supreme gjen se, për arsye të njëjta se ankuesi nuk është në gjendje të dëshmojë cilësinë e tij si kryefamiljar i familjes me bartësen e të drejtave pronësore, ai nuk mund ta dëshmojë lidhjen e tij familjare në mes të tij dhe motrave të pretenduara.

Për më tepër, ankesa e është e papranueshme. Paraqitja e kërkesës shtesë do të thotë ndryshimi i kërkesës. Sipas neneve 258.1 dhe 258.2 të Ligjit 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore, paraqitësi i kërkesës munda ta ndryshoj kërkesën jo më vonë se përfundimi i shqyrtimit gjyqësor në nivelin e shkallës së parë. Në rast se nuk ka shqyrtim në shkallën e parë, është e qartë se ndryshimi i kërkesës duhet të bëhet para seancës këshilluese në mënyrë që të mund të shqyrtohet nga gjykata e shkallës së parë. Megjithatë, nuk mund të bëhet për herë të parë pranë gjykatës së shkallës së dytë.

Përveç kësaj, Gjykata Supreme gjen se sidoqoftë ankuesi nuk ka të drejtë të veprojë në emër të motrave të tij. Neni 5.2 i Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut Nr. 2007/5 i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, thotë:

“Në procedurat para Komisionit, kur personi juridik nuk mund të bëjë kërkesën, e njëjta mund të bëhet nga anëtari i familjes së atij personi”

Neni 1 i UD së njëjtë përkufizon “anëtar i familjes” do të thotë “bashkëshorti apo bashkëshortja, fëmijët dhe personat e tjerë, të cilët është i obliguar t’i përkrahë poseduesi i të drejtës në pronë në përputhje me ligjin në fuqi, apo personat që janë të obliguar ta përkrahin poseduesin e të drejtës në pronë në përputhje me ligjin në fuqi, pavarësisht nëse ai person ka banuar në atë pronë së bashku me poseduesin e së drejtës në pronë apo jo”.

As dëshmia mbi paaftësinë e motrave të pretenduara për të paraqitur kërkesë e as elementet që korrespondojnë me këtë përkufizim nuk janë përmbushur në këtë lëndë.

Si rezultat, kjo kërkesë është e papranueshme dhe hidhet poshtë. Ky vendim nuk e pengon personin në emër të cilit ka vepruar ankuesi që të paraqes kërkesë pranë gjykatës së rregullt dhe kompetente.

Rrjedhimisht, në bazë të arsytimit ligjor të lartpërmendur, vendimet e KKPK-së, pranohen.

Shpenzimet e procedurës:

Sipas nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UD) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës pranë Sekretariatit Ekzekutiv dhe Komisionit.

Sidoqoftë, në lirim i tillë nuk parashihet për procedurat pranë Gjykatës Supreme.

Si rrjedhojë, regjimi normal i tarifave të gjykatës siç është paraparë me Ligjin mbi Tarifat e Gjykatave (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe sipas UD-së Nr. 2008/02 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e tarifave të gjykatave janë të aplikueshme për procedurat pranë Gjykatës Supreme.

Prandaj, tarifat në vijim janë të aplikueshme në këtë procedurë ankimore:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UD-së 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për lëshimin e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.1 të UD-së AD 2008/2), duke e marrë parasysh se vlera e gjithmbarshme e kësaj prone në fjalë e përbërë nga sipërfaqja prej 0. 14. 67 ha e livadheve dhe 0. 64. 08 ha e pyjeve në Komunën Kadastrale Zebincë dhe sipërfaqja prej 3.38.60 ha si tokë e kultivuar, 0. 60. 10 ha si livadhe dhe 6. 60. 21 ha e pyjeve në Komunën Kadastrale Parallovë do të mund të kalkluohej në mënyrë të arsyeshme si vlerë në shumë prej 32.000 €: 50 € + 0.5% e 32.000 = 210 €

Këto shpenzime gjyqësore do të mbulohen nga ankuesi i cili e humb lëndën.

Sipas nenit 46 të Ligjit Mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati kohor i pagimit të taksave nga individ i cili ka vendbanim ose vendqëndrim jashtë nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në rastin konkret, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhen nga ankuesi në afat prej 90 ditësh nga dita kur aktgjykimi i është dorëzuar atij.

Këshilla ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe i zbatueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve juridike të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

Nënshkruar nga: Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e kolegjit e EULEX-it

Nënshkruar nga: Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it

Nënshkruar nga: Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Nënshkruar nga: Urs Nufer, Regjistruer i EULEX-it